



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 115 AKTI

NR. 148 VENDIMI  
Tiranë, më 16.5.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Etleda Çiftja** Kryesuese  
**Pamela Qirko** Anëtare  
**Genta Tafa (Bungo)** Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, më datë 13.5.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Artan Shtrungza**, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (në vijim “Kushtetuta”).  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”);

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, z. **Artan N. Shtrungza**, ushtron detyrën e prokurorit/drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, detyrë të cilën e ka filluar në muajin korrik të vitit 2010 dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ai u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2018, në përputhje me rregullore “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Shtrungza.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme (PP), si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.

Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një

raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- 1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- 2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- 3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- 4) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- 5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë 11.4.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Shtrungza.*

**Prokuroria e Përgjithshme** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 26.4.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 26.4.2019. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 7.5.2019.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, në datën 7.5.2019.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 13.5.2019, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Artan Shtrungza ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- dh) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaron këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. **Banesë private me vendndodhje në fshatin \*\*\*, Tropojë**, e ndërtuar përpara vitit 1990, me sipërfaqe 108 m<sup>2</sup>, e pargjistruar që në atë periudhë në organet përkatëse dhe aktualisht e pargjistruar. Rikonstruktuar përgjatë viteve, duke shpenzuar shumën prej 1, 800,000 lekë. Zotërimi: 100 %.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: trashëguar nga prindërit.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni:**

- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2018 e ZQRPP-së, drejtuar zvrpp-ve dhe për dijeni Komisionit.  
Kthim përgjigje negative, ZVRPP-ja Tropojë, nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2018
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018, drejtuar OSHEE-së.  
Kthim përgjigjeje negative, nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2018, e OSHEE-së.

#### **Arsyetimi ligjor**

- A. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte depozituar pranë ILDKPKI-së dokumentacion për të provuar pronësinë apo posedimin e tij mbi këtë banesë.

Gjatë hetimit administrativ atij iu kërkua dokumentacion dhe informacion i detajuar në lidhje me këtë banesë. Subjekti i rivlerësimit dha shpjegime të hollësishme duke saktësuar, se shtëpia ishte në pronësi të tij dhe familjarëve të tij, si dhe vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e mëposhtëm:

- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 12.3.2019 e z. E. Sh.;
- Deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 11.3.2019 e z. L. Sh.;
- Kontratë kredie bankare e datës 19.4.2018;
- Kontratë kredie bankare e datës 9.10.2013;
- Kontratë kredie bankare e datës 3.3.2011;
- Kontratë për shërbime “Ujësjellës-Kanalizime” e lidhur në datën 3.1.2019;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019, i kryesisë së fshatit \*\*\*;
- Librezë pagese uji në emër të z. Artan Shtrungza;
- Verifikim debie (lidhje e re) i OSHEE-së, datë 30.1.2018;
- Vërtetim i OSHEE-së, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, me të cilin vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar më datë 4.5.2018 për lidhje të re me OSHEE-në;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i Njësisë Administrative \*\*\*.
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i ZVRPP-së Tropojë;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i Bashkisë Tropojë;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i ZVRPP-së Tropojë;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i ZVRPP-së Tropojë;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019, i kryesisë së fshatit \*\*\*;
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2019, i Njësisë Administrative \*\*\*;
- Vërtetim i Njësisë Administrative Llugaj, datë 8.3.2019;
- Foto të banesës aktuale dhe të asaj të mëparshme.

Referuar deklaratave të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar, rezulton se banesa është ndërtuar përpara viteve ‘90 dhe nuk është regjistruar për shkak të problematikave që vetë institucionet kanë pasur, duke mos bërë regjistrimet e banesave që në fazat e para të dokumentimit. Ky fakt provohet me vërtetimet e marra pranë ZVRPP-së Tropojë, Bashkisë Tropojë dhe Njësisë Administrative \*\*\*, të cilat janë paraqitur edhe nga subjekti. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se të gjitha banesat e zonës kanë të njëjtin problem dhe janë të paregjistruara për të njëjtën arsye, pasi nga institucionet nuk është bërë regjistrimi fillestar i tyre.

Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të subjektit të rivlerësimit ndër vite rezulton se ai ka deklaruar gjithmonë të njëjtën adresë banimi që përkon me banesën e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

**B.** Në lidhje me këtë banesë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se e ka rikonstruktuar me një vlerë totale prej 1,800,000 lekë.

Gjatë hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit iu kërkua që të jepte një informacion më të detajuar në lidhje me kohën e rikonstruktimit si dhe të paraqiste dokumentacion provues për shumën e shpenzuar. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Për shkak të mungesës së mjeteve financiare, banesa ka qenë shumë e amortizuar gjatë viteve. Nuk mund të flas*

*për ndonjë rikonstruksion total të saj në kuptimin e ndryshimit të konstruktit të banesës apo tjetër, por për riparime të saj.”*

Nga deklaratimet e subjektit rezulton se banesa është riparuar fillimisht në vitin 2008, kur subjekti ishte me detyrë oficer i policisë gjyqësore. Më pas, subjekti detajon se: **“Banesa është riparuar në vitin 2011, dhe janë kryer punime, si suvatime të jashtme të mureve dhe vendosje materiali izolues përreth banesës për të evituar lagështirën. Shpenzimet e riparimeve kanë qenë rreth 400.000 (katërqind mijë) lekë dhe burimi i financimit të shpenzimeve kanë qenë një kredi bankare që kam marrë në “Raiffeisen Bank” Tropojë, në vitin 2011. Sqarohet se nuk janë mbajtur fatura shpenzimesh për të detajuar shpenzimet, por shuma është afërsisht si më sipër. Po ashtu banesa është riparuar në vitin 2013 dhe janë kryer punime, si shtrimi i pllakave, ndërrim i dyerve dhe dritareve, suvatime të mureve të brendshme, ndërrim i pajisjeve të tualetit. Shpenzimet e riparimeve kanë qenë rreth 800.000 (tetëqind mijë) lekë dhe burimi i financimit të shpenzimeve kanë qenë nga kredia bankare prej 1.000.000 (një milion) lekësh, që kam marrë në vitin 2013 në “Raiffeisen Bank”, Tropojë.”**

Megjithatë subjektit iu kërkua dokumentacion mbështetës për të vërtetuar shpenzimet e kryera, ai ka deklaruar se është në kushtet e pamundësisë për të depozituar dokumentacion, për më tepër që shumica e punimeve janë kryer nga vëllai i tij dhe të afërm.

Komisioni, për të krijuar bindjen për saktësinë e deklaratimeve të subjektit, i kërkoi atij foto të banesës përpara dhe pas rikonstruksionit. Nga krahasimi i fotove rezulton se kjo banesë është rikonstruktuar ashtu sikundër ka deklaruar subjekti i rivlerësimit. Nga analiza financiare rezulton që subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për rikonstruksionin e banesës. Ky fakt mbështetet edhe në kreditë bankare, që subjekti ka marrë në vitet kur ka deklaruar rikonstruksionin e banesës.

Gjatë pyetjeve të pyetësorëve të bërë nga ana e Komisionit, subjekti ka deklaruar se prej gjashtë muajsh ka arritur një marrëveshje paraprake me Xhaxhain, shtetasin L. Sh., që t'i blejë banesën e tij njëkatëshe, e cila ndodhet në fshatin \*\*\*, ngjitur me banesën në të cilën subjekti jeton aktualisht, banesë e cila gjithashtu është ndërtuar përpara viteve 1990 dhe është e pajisur, siç janë banesat e tjera në fshatin \*\*\*, për shkaqet e përmendura më sipër. Subjekti ka dërguar foto të kësaj banese, si dhe ka sqaruar se do të procedojë me aktin e blerjes, sapo të kryhen procedurat e regjistrimit të pronës.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklaratimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

2. **Në lidhje me:** automjetin “Mercedes Benz” tip. 210, autoveturë me vit prodhimi 1998, targa \*\*\*, e blerë me kontratë shitblerje në datën 30.11.2016, në shumën prej 150,000 lekë. Zotërimi: 100 %.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 30.11.2016.

### **Hetimi i Komisionit**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019, drejtuar noterit publik, znj. G. B. Kthim përgjigje, datë 8.2.2019, e noterit publik.

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019, drejtuar noterit publik, z. I. H. Kthim përgjigjeje, datë 5.2.2019, e noterit publik.

- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018, e DPSHTRR-së. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2018, e DPSHTRR-së.

- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019, drejtuar noterit publik, znj. E. D. Kthim përgjigjeje, nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2019, e noterit publik.

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019, drejtuar DPSHTRR-së. Kthim përgjigjeje, nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2019, e DPSHTRR-së.

### **Arsyetim ligjor**

**A.** Subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. \*\*\*, të datës 30.11.2016, ka blerë automjetin tip “Mercedez Benz”, me targa \*\*\*, për shumën prej 150,000 lekë.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti i ka pasur mundësitë financiare për blerjen e këtij automjeti. Këtë automjet subjekti i rivlerësimit e ka shitur në datën 27.9.2017, me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 1.000 euro.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij, konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

**B.** Pas plotësimit të deklaratës “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. \*\*\*, të datës 30.8.2017, ka blerë automjetin tip “Mercedez Benz”, me targë \*\*\*, për shumën 2.000 euro.



Ky automjet është shitur me kontratën nr. \*\*\*, në datën 6.10.2017, për shumën prej 300,000 lekë.

Në po të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. \*\*\*, ka blerë automjetin tip “Mercedez Benz”, me targë \*\*\*, për shumën 300,000 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nuk kanë rezultuar paqartësi apo dyshime në lidhje me këto automjete.

**3. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” gjendjen *cash* në vlerën prej 200, 000 lekë.**

Nga dokumentacioni i administruar, si dhe analiza financiare, rezulton që subjekti mund t’i kishte këto të ardhura *cash*. Komisionit nuk i kanë lindur dyshime mbi mundësinë e kursimit të këtyre të ardhurave.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklaram. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

**4. Lidhur me: kontratë kredie konsumatore, lidhur me “Raiffeisen Bank”, në datën 9.10.2013, për shumën prej 1,000,000 lekë; qëllimi: rikonstruksion banese, afati 5 vjet, datë fillimi 10.10.2013 – datë përfundimi 10.10.2018; interesi 11.46 %; numri i kësteve 60. Gjendja e detyrimit në vlerën: 567, 577 lekë.**

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- *Kontratë kredie, datë 9.10.2013.*
- *Tabelë amortizimi kredie, datë 24.1.2017.*

**Hetimi i kryer nga Komisioni:**

- Shkresë, nr. \*\*\*, datë 3.4.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018, e “Fibank”. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2018, e “Raiffeisen Bank”.
- Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019, drejtuar “Fibank”. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2019, e “Fibank”.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2019, drejtuar noterit publik, znj. E. D. Kthim përgjigje, nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2019, e noterit publik.

➤ Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2019, drejtuar Shoqërisë së Parë Financiare, “\*\*\*\*” dega Tropojë.

Kthim përgjigjeje nr. \*\*\*, datë 8.3.2019, e “\*\*\*\*”.

### Arsyetimi ligjor

A. Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka kredi të marrë në datën 10.10.2013, në shumën 1,000,000 lekë, si dhe ka pasur disa kredi të cilat aktualisht janë të mbyllura.

Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në këtë bankë, Komisioni konstatoi se janë bërë disa transferta nga persona të ndryshëm.

Subjekti i rivlerësimit, pasi u pyet në lidhje me këto tranferta dhe personat që i kanë kryer, ka sqaruar se njëri nga këta shtetas është i vëllai, z. E. Sh., i cili këto para i ka derdhur në llogarinë rrjedhëse të tij, kur subjektit i janë nevojitur gjatë një udhëtimi në Tiranë, dhe ka kërkuar ndihmën e të vëllait, i cili i ka marrë këto para nga gjendja që kanë pasur në banesë. Shtetasi tjetër, që ka derdhur të holla në llogarinë e subjektit shumën prej 10,000 lekësh, është kolegu i tij, z. A. I., prokuror në Tropojë, që ka të afërmit në këtë qytet, ndërkohë që vetë jeton në Tiranë. Komisioni konstaton që ky deklaram i subjektit për këtë shtetas është i saktë.

Ndërsa për shtetasin tjetër, z. A. N., subjekti ka sqaruar se e ka bashkëfshatar dhe se ka njohje me të që nga jeta studentore. Subjekti ka sqaruar se: *“Prindërit e A., janë banorë të fshatit \*\*\* ku unë jetoj, ndërsa A., jeton në Tiranë. Në të dy rastet më ka kërkuar që për shkaqe urgjente t’i jap babait të tij shumat nga 10,000 lekë në të dy rastet, të cilat ja kam dhënë nga të ardhurat e mia dhe më pas A., i ka transferuar ato në llogarinë time.”*

Në përfundim të hetimit, së bashku me rezultatet, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumentacion këtë marrëdhënie me shtetasin A. N.

Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale të shtetasit A. N., me të cilën provohet ky fakt. Nga regjistri i gjendjes civile rezulton se shtetasi A. N., është nga i njëjti fshat me subjektin.

B. Nga hetimi administrativ, bazuar në shkresën e “Fibank”, rezulton se subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e garantorit në një kredi, e cila rezulton e pashlyer me të dhënat e detajuara më poshtë:

Kredimarrës: z. N. D. Sh.

Shuma: 6.000 euro.

Afati 12.12.2007 - 12.12.2012.

Data e fshirjes: 14.8.2015.

Kjo kredi nuk rezulton e deklaruar nga subjekti. Në këto kushte Komisioni i ka kërkuar sqarime nga subjekti. Ai ka deklaruar se kjo është një kredi e marrë nga xhaxhai i tij, z. N. Sh. Sipas subjektit ai nuk ka qenë dhe nuk ka firmosur si garantor i saj, por dikush tjetër ka nënshkruar në emër të tij.

Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur:

- Kërkesë, datë 28.6.2013;
- Ekstrakt nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paditur "Fibank" me objekt padie: "Konstatim i pavlefshmërisë së pjesshme të veprimit juridik kontratë kredie bankare."
- Ankesë, datë 4.10.2017, drejtuar Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- Vendim për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\*.

Në vendimin e pushimit të çështjes penale nr. \*\*\*, rezulton se:

*Në aktin e ekspertimit nr. \*\*\*, të Drejtorisë së Policisë Shkencore ndër të tjera është konkluduar se te dokumenti, kontratë kredie bankare nr. \*\*\*, datë 11.12.2007, Banka e Parë e Investimeve, pika 3, shkrimi i emër mbiemrit të kallëzuesit, z. Artan Shtrungza, dhe nënshkrimi (firma) në të djathtë të tij të ndodhura në rubrikën dorëzanësit në faqen 13 dhe nënshkrimet përkatëse në emër të këtij shtetasi të ndodhura në fundet e 12 faqeve të dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, nuk janë shkruar e nënshkruar nga shtetasi Artan N. Shtrungza krahasuar me modelet e paraqitura.*

Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka qenë i përfshirë në këtë kredimarrje, dhe për pasojë nuk ka pasur detyrim për të deklaruar.

##### **5. Nga analiza financiare ndër vite rezulton se:**

Subjekti ka pasur mungesë të të ardhurave për të mbuluar shpenzimet e kryera në vitin 2016 në shumën prej -119,632 lekë. Për këtë, së bashku me rezultatet e hetimit, iu kërkua të shpjegojë bindshëm të kundërtën e këtij rezultati.

Subjekti ka shpjeguar se: *"Në periudha të ndryshme kam pasur dhe shpenzime të ndryshme, në varësi dhe të gjendjes ekonomike, duke u përpjekur që të përshtat shpenzimet me të ardhurat. Bazuar dhe në përlllogaritjet e bëra për shpenzimet familjare çmoj se duhet të merret parasysh fakti se gjatë gjithë kohës kur kam jetuar në fshat një pjesë të madhe të nevojave për konsum ushqimor familjar i kam siguruar nga puna e bashkëshortes pranë banesës, duke u marrë me kultivimin e fruta-perimeve, me rritjen e shpendëve etj."*

Në vlerësimin e tij, Komisioni, ka marrë parasysh faktin se bashkëshortja e subjektit nuk është e angazhuar në punë, duke iu dhënë kështu mundësia që t'i përkushtohet aktivitetit shtëpiak. Nga pamjet e shtëpisë në fshat, konstatohet dukshëm shfrytëzimi i oborrit të banesës, duke i konstatuar kështu bindëse shpjegimet e subjektit.

Komisioni arrin në këtë konkluzion edhe duke u mbështetur në parimin e proporcionalitetit, duke e konsideruar këtë mungesë të ardhurash vetëm për një vit, si shkak të pamjaftueshëm për të ngritur dyshime për veprime korruptive apo cenim të figurës së prokurorit.

### **Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit**

Pas hetimit në mënyrë të thelluar të të ardhurave, të shpenzimeve, si dhe të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Artan Shtrungza, ka qenë i saktë në deklarin e tij në deklaratën “Vetting”.

Komisioni çmon se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Subjekti nuk rezultoi të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, si dhe nuk ka asnjë indicie për fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Shtrungza.**

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe nga ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në

kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2018. Ky raport i hollësishëm dhe i arsyetuar është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) Pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënave nga 23 prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga analiza e tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti nuk janë konstatuar mangësi.

Nga analiza e pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, janë konstatuar:

- 1. Në lidhje me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 25.1.2014, për veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur pushimi i procedimit penal në datën 11.4.2014.**

Nga aktet e dosjes hetimore rezultoi se mbajtja e paligjshme e municionit është konstatuar në datën 24.1.2014, ndërkohë ligji nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie” (neni 5) i ka shtrirë efektet deri në datën 31.12.2013, pra, ka amnistuar të gjithë personat, të cilët, deri në këtë datë, kanë kryer vepra penale që parashikojnë në maksimum dënim deri në dy vjet burgim

ose dënim më të lehtë. Për sa më sipër rezultoi se vendimi i pushimit është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ka pranuar se ka gabuar në këtë vendimmarrje, por kjo ka ardhur si pasojë e mbingarkesës në punë, nisur nga fakti se nga muaji nëntor 2013 deri në qershor 2014 ka qenë jo vetëm drejtues i prokurorisë, por edhe prokuror i vetëm në atë prokurori, asistuar vetëm nga një oficer i policisë gjyqësore. Ai ka sqaruar se gjatë kësaj periudhe ka përballuar i vetëm një ngarkesë të madhe pune. Për të vërtetuar që ky gabim nuk ka ardhur si pasojë e favorizimit të pandehurit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar vendimin nr. \*\*\*, datë 6.1.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, nga ku rezultoi se z. A. K., pasi është arrestuar po në vitin 2014, është dënuar nga kjo gjykatë për veprën penale të vjedhjes.

Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në arsyetimin e tij, duke shpjeguar mbingarkesën e punës në atë vit. Vendimmarrja e tij nuk është në përputhje me parashikimet e ligjit “Për amnistinë”, por kjo vendimmarrje nuk mund të përbëjë shkak për shkarkimin e tij.

2. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 28.3.2014, ndaj të pandehurit A. D., për kryerje të veprës penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, për të cilën është vendosur dërgimi i procedimit penal për gjykim, në datën 23.12.2014.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes hetimore, rezultoi se:

- a. Në aktin e njoftimit të akuzës ndaj të pandehurit A. D., nuk është specifikuar se në bazë të cilit paragraf të nenit 143 të Kodit Penal është akuzuar i pandehuri.
- b. Nisur nga rrethanat e çështjes, konstatohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale të mashtrimit, përmes shumë episodeve, në vlerën totale prej 3,5 milion lekë. Në këto rrethana, si duke u nisur nga numri i episodeve, ashtu edhe nga pasoja e rëndë, shkaktuar të dëmtuarit (3,5 milion lekë), nga ana e subjektit të rivlerësimit, i pandehuri duhej të ishte akuzuar sipas paragrafit të dytë të nenit 143 të Kodit Penal.
- c. Nuk janë respektuar kërkesat e neneve 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me afatet e hetimit.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit pranon rezultatin e hetimit të Komisionit, por e ka arsyetuar kështu: *“Gjatë kësaj periudhe jam munduar të jem sa më i vëmendshëm dhe i saktë në kryerjen e detyrës, por vërej se ngarkesa e madhe në punë ka pasur dhe ndikimin e vet në ndonjë moment të vendimmarrjes, por sqaroj se kjo është e vetmja arsye për vendimmarrjen e gabuar dhe nuk ka pasur asnjë arsye apo motivim tjetër.”*

Komisioni e konsideroi bindës shpjegimin e subjektit, shpjegim ky i mbështetur edhe nga analiza e ngarkesës në punë të tij. Nga statistikat e përgatitura për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e dosjeve, konstatohet se vetëm gjatë vitit 2014, subjekti ka pasur në ngarkim 192 çështje, që janë pothuajse gjysma e ngarkesës për të gjithë periudhën trevjeçare të rivlerësimit. Këto pasaktësi të kryera nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedimin penal, për sa kohë nuk kanë sjellë pasoja të rënda apo shumë të rënda, nuk mund të përbëjnë shkak për shkarkimin e tij.

3. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 31.10.2014, në ngarkim të shtetasit F. Q., për kryerje të veprës penale “Vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i Kodit Penal, për të cilin është vendosur dërgimi për gjykim, në datën 28.12.2015, ndaj të pandehurit H. M.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes hetimore, rezultoi se:

1. Në kushtet kur gjykimi është kryer me procedurë të përsheptuar dhe nuk janë marrë prova të reja, ndryshimi i qëndrimit të prokurorit në lidhje me akuzën nga paragrafi i dytë në paragrafin e parë të nenit 137 i Kodit Penal, është i paargumentuar.
2. Nuk janë respektuar kërkesat e neneve 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me afatet e hetimit.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se, kërkesa për dënim për veprën penale të parashikuar nga neni 137/1 dhe jo 137/2 të Kodit Penal, është një lapsus në shkrim gjatë përpilimit të konkluzioneve, pasi qëllimi i prokurorit ka qenë për dënimin e të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 137/2 të Kodit Penal.

Komisioni konstaton se të gjitha dokumentet përbërëse të dosjes hetimore, të hartuara nga subjekti, është aplikuar neni 137/2 i Kodit Penal. Edhe analiza dhe argumentimi i veprës janë në frymën e nenit 137/2.

Komisioni e konsideron bindës shpjegimin e subjektit për një lapsus në shkrim.

**Për këtë subjekt ka pasur dy denoncime, si më poshtë:**

1. Në lidhje me denoncimin e bërë nga S. B., pas hetimit, rezulton se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptuese nga ana e subjektit të rivlerësimit.
2. Në lidhje me denoncimin e bërë nga M. K., Komisionit i ka rezultuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit është shpallur moskompetenca në lidhje me procedimin penal të nisur, pas një viti nga regjistrimi i kallëzimit.

Nga analizimi i vendimit të subjektit të rivlerësimit rezulton se ky procedim ka zgjatur më shumë se një vit dhe pas kryerjes së disa veprimeve hetimore është vendosur të shpallet

moskompetenca. Vonesa në marrjen e vendimit bazuar në deklaratimet e subjektit ka ardhura si pasojë e administrimit të disa shkresave, të cilat ishin të nevojshme për procedimin. Pas administrimit të tyre, subjekti i rivlerësimit ka vendosur të shpallë moskompetencën, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë që të jetë kryer ndonjë veprë penale në rrethin e Tropojës. Për sa më sipër nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

## **ANALIZA E GJETJEVE**

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme; dhe (iv) denoncimeve të publikut.

### **1. Aftësitë profesionale**

#### **a. Njohuritë ligjore**

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Referuar vlerësimit në aspektin profesional rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

Referuar të dhënave të administruara është konstatuar se në një rast vendimi i pushimit nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie”, si dhe në një rast subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar dhe nuk ka përcaktuar saktë bazën ligjore për akuzën e ngritur ndaj të pandehurit.

Komisioni, duke u bazuar në të dhënat për volumin e punës së përballuar nga ky prokuror, si dhe në vendimin nr. \*\*\*, të datës 18.01.2017<sup>1</sup>, të Gjykatës Kushtetuese çmon se këto pasaktësi të subjektit të rivlerësimit të kryera gjatë punës së tij si pasojë e ngarkesës dhe e mungesës së stafit, nuk përbëjnë gabime thelbësore dhe/apo serioze, si dhe nuk ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara nga ana e subjektit të rivlerësimit, që të tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

---

<sup>1</sup> 54. Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (*shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*).



## **b. Arsyetimi ligjor**

Bazuar në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara, subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave dhe ballafaqimin e tyre me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton në përgjithësi rregullat e drejtshkrimit.

## **2. Aftësitë organizative**

### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Subjekti i rivlerësimit ka trajtuar gjithsej 461 (katërqind e gjashtëdhjetë e një) çështje gjatë periudhës objekt rivlerësimi. Duke pasur parasysh organizimin e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, ngarkesën në hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të çështjeve penale, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është përballuar me një ngarkesë të konsiderueshme pune.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ushtron vendimmarrje brenda një afati të arsyeshëm, ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, pa dëmtuar ecurinë e çështjeve. Nga gjetjet në dokumentet ligjore rezulton se afatet kohore të zgjidhjes së praktikave që kanë lidhje me dokumentet ligjore të përzgjedhura me short, janë të arsyeshme në raport me natyrën dhe kompleksitetin e praktikave përkatëse.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti, në përgjithësi ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

### **b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore**

Subjekti i rivlerësimit kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

Komisioni ka konstatuar se në dy raste nuk janë respektuar nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me marrjen e vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve. Në të dy këto raste, Komisioni ka vlerësuar se kjo neglizhencë e subjektit nuk mund të përbëjë shkak për ta konsideruar atë të paaftë apo të papërshtatshëm, duke marrë në konsideratë mbingarkesën e tij në punë për shkak të mungesës së stafit në prokurorinë e Tropojës.

### **c) Aftësia për të administruar dosjet**

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### **a) Etika në punë**

Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, nuk rezultojnë të dhëna apo elemente për të konkluduar rreth etikës në punë.

#### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Shtrungza, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### **c) Paanësia**

Nga tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Shtrungza. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu asnjë prej tre dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tre dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### **a) Aftësitë e komunikimit**

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna të caktuara që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

#### **b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Në tre dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

**b) Gatishmëria për t'u angazhuar**

Prokurori Artan Shtrungza, subjekt rivlerësimi, nuk ka depozituar certifikata trajnimesh për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës.

**Konkluzioni përfundimtar mbi aftësitë profesionale të subjektit**

Në përfundim të kësaj analize, duke e parë çështjen në tërësi, duke konsideruar volumin e punës të përballuar nga subjekti me cilësinë e drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorit, shumica vlerëson se mangësitë e konstatuara nga studimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me anë të një sistemi objektiv dhe rastësor, nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën “b” dhe “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Këto mangësi nuk mund të konsiderohen si cilësi të papranueshme në punë apo gjykim i dobët, që të sjellin lindjen e nevojës për program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, apo shkarkimin nga detyra si të papërshtatshëm. Gjithashtu nuk u evidentuan raste të shkeljes së të drejtave të palëve ose viktimave. Duke qenë se nga studimi i dokumentacionit të administruar u konstatuan mangësi vetëm në dy raste për sa i përket njohurive ligjore, të gërshetuara me arsyetimin ligjor, si dhe dy raste të të njëjtës mangësi në procedurë, shumica vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Shtrungza, ka plotësuar kriterin e parashikuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

**D. KONKLuzioni Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pika 1 e nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

**V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Shtrungza.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 16.05.2019.

### ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

**ETLEDA ÇIFTJA**


**Kryesuese  
(Kundër)**



**PAMELA QIRKO**  
**Anëtare**



**GENTA Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**



**Sekretare gjyqësore**  
**Fiorela Mandro**

